

Burimet: deklarata A.B, FDH-31229; USCG KGDH, *Regjistri...*, FDH-8817; KMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; SMIP, *Teroristički...*, III, 924; *Dnevnik od 11. do 17. novembra*, Ilustrova-na na politika, FDH-32280.

Demë (Osmon) Muçaj

(7.07.1945, shqiptar nga Lluka e Epërme/Gornja Luka, komuna e Deçanit/Deçani, bujk)

Demë Muçaj jetonte në Llukën e Epërme/Gornja Luka. Kurrë nuk u martua. Jetonte te familja e të vëllait Shabanit. Në datën 13.11.1998, ai u nis në fshatin Glllogjan/Glođane për të vizituar hallën e vet. Ishte kjo ditë kur familjarët e shihnin të gjallë për herë të fundit. Dy ditë më vonë, më 15.11.1998, familjarët mësuuan se disa gra nga fshati e kishin parë Demën të shtrirë në tokë pranë postblokut policor, te lagja e refugjatëve në fshatin **Baballoq/Babaloc**, përderisa policët përgatiteshin ta tërhiqnin trupin e tij. Familjarët kishin drojë të shkonin dhe merrnin trupin e Demës. Në muajin shkurt të vitit 1999, familja kishte mësuar se Demën e kishin varrosur në lagjen e refugjatëve në Baballoq/Babaloc. Më në fund, axha i Demës shkoi në Baballoq/Babaloc që t'i merrte mbetjet mortore të Demës. Disa refugjatë i treguan për vendndodhjen e varrit. Po atë ditë, ai i zhvarrosi mbetjet mortore të Demës dhe i rivarrosi në varrezat e Llukës së Epërme/Gornja Luka.

Burimi: deklarata S. M, FDH-17043.

Jånós (Màtyàs) Csizmadia

(3.12.1953, hungarez nga Senta, një fëmijë, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)

Zoran (Božidar) Vrbaški

(12.01.1973, serb nga Fshati i Savës, komuna e Vërbasit, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)

Igor (Mihalj) Buš

(7.11.1973, jugosllav nga Kanjizha, dy fëmijë, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)

Pas trajnimit të përfunduar për oficer police, Jånosi filloi nga puna në stacionin policor të Sentës. Igori dhe Zorani punonin në stacionin e policisë në Kanjizhë. Igori e

kishte të përfunduar Shkollën e Punëve të Brendshme në Kamenicën e Sremit dhe ishte punësuar në MPB-në e Serbisë që nga viti 1992. Zorani punonte në MPB-në që nga viti 1997, kur e mbaroi trajnimin për polici. Disa herë kanë shkuar me detyrë në Kosovë. Herën e fundit në nëntorin e vitit 1998, në kuadrin e njësitit nga Senta. Jånosi ishte komandant i togut. Detyra e tij ishte të kujdesej për ndërresat e rojës, që mbahej nëpër postbloqet policore në rajonin e tyre operativ.

Në datën **20.11.1998**, Jånosi po e ngiste furgonin zyrtar me policët që ktheheshin nga roja. Në mesin e tyre ishin edhe Igori dhe Zorani. Te ura në **Prilep**, pjesëtarë të UÇK-së e kanë hedhur një bombë mbi furgonin. Zorani u vra në vend, ndërkaq Igori, Jånosi dhe një polic tjetër u plagosën rëndë. Jånosi ka dhënë shpirt në rrugë për në spital. Igori u transferua në spitalin e Prishtinës/Priština, ku iu nënshtua intervenimit kirurgjikal. Më pas, e transferuan në AMU në Beograd. Ishte në gjendje të pavetëdijshme deri më **27.11.1998**, kur dha shpirt.

Igorin e kanë varrosur ditën e nesërme në varrezat e Kanjizhes. Jånosi u varros më 22.11.1998 në varrezat katolike në Sentë.

Burimet: deklarata M.B, FDH-29980; deklarata C.M, FDH-21055; SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 17, 20, 74; KMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; SMIP, *Teroristički...*, III, 942; ICTY, IT-05-87 (Milutinović dhe të tjerë), EX.3D01022, FDH-33285; Z. Stijović, *Kosmet...*, 109, 110; *Pripadnici Ministarstva unutrašnjih poslova - žrtve albanskog terorizma u 1998.godini*, na <http://www.srbija-info.yu/vesti/1999-02/19/9769.html>, FDH-31078.

Valon (Osman) Malaj

(27.10.1981, shqiptar nga Gjakova/Đakovica, nxënës, pjesëtar i UÇK-së)

Dominik (Tush) Përgegaj

(4.05.1982, shqiptar nga Gjakova/Đakovica, nxënës, pjesëtar i UÇK-së)

Valoni, 17 vjeç, dhe Dominiku, 16 vjeç, kanë rënë gjatë luftimeve me forcat serbe në **Glogjan/Glođane**, më **17.12.1998**. Gjatë tërheqjes, forcat serbe i kanë marrë me vete trupat e tyre dhe i kanë varrosur